



## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Data: 18.11.2024

### PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje automjeti të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):**

Automjete 34100000-8

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 6,335,589 (gjashtë milion e treqind e tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

##### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

1. OE duhet të paraqese vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të lotit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

**a.** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**b.** Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në

fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të mallit objekt prokurimi. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallit që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e autoveturave objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisin e tij / një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.

**Argumentimi:** Bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se disponojnë mjediset e përshtatshme të autorizuar për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent;

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike nga prodhuesi /ose distributori i autorizuar ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

6. Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE. Për të vërtetuar këtë duhet të paraqesë deklaratën e cila të jetë e shoqëruar me çertifikatën e konformitetit (CoC)/ekuivalent.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave, objekt prokurimi. Duke qenë se mjeti është kërkuar të jenë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, detyrimisht është kërkuar paraqitja e çertifikatës së konformitetit si dokumenti zyrtar i cili vërteton se një produkt plotëson standartet europiane të sigurisë, cilësisë, performancës, emetimit të gazrave dhe mbrojtjes mjedisore. Gjithashtu certifikata është një nga dokumentet e detyrueshëm që shoqëron automjetin për të vijuar me regjistrimin e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor

7. Deklaratë garancie për mjetin e ofruara, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 2 (dy) vite ose minimumi 150.000 km, në varësi se cili kusht do të plotësohet i pari.

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë

shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

**8.** Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuara dhe regjistruara në pronësi të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (zhdoganimin, regjistrimin, targimin me targa shqiptare, siguracion).

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

#### **SPECIFIKIME TEKNIKE**

- Viti i prodhimit 2024
- Përmasat: gjatësia jo me pak se 530-540 cm, gjerësia 270-280 cm me pasqyra
- Automjeti duhet të jete ne konfigurimin e hapësirës i llojit minivan dhe me nr. e personave të transportueshëm të paktën 7+1.
- Diferenciali i pasëm
- Pesha bosh e aksit te pare te paktën 1306 kg
- Pesha bosh e aksit të pasem te paktën 1030 kg
- Pesha maksimale e lejuar e aksit te pare 1550 kg
- Pesha maksimale e lejuar e aksit te pasëm 1550 kg
- Peshëmbajtja 760-770 kg
- Pesha maksimale me ngarkese 3100 kg
- Cilindrata te paktën 1950 cm<sup>3</sup>
- Motorri me fuqi te paktën 100kw/ 136HP
- Fuqia ne momentin rrotullues 330NM
- Kambio automatike me 9 raporte
- Lloji i karburantit, nafte
- Boje e zeze metalike
- Kamera e pasme
- Materiali i veshjeve duhet të jete pëlhurë dhe ngjyra e veshjeve te brendshme duhet të jete e zeze
- Pjese të kroskotit dhe dorezat e dyerve duhet të jene te kromuara
- Disqe alumini te derdhura, goma vere 225/55R17, matës presioni tek gommat
- Kufizues shpejtësie 210km/h
- Tregues shpejtësie elektronik
- Filtër nafte me ndarës uji

- Sistem i kontrollit te emetimit te gazrave
- Klasifikimi i emetimeve Euro 6e
- Xham termo-izolues
- Panele nen tavan
- Dritare te pasme
- Xhama te errësuar
- Dritarja e pasme me funksion larje
- Dere rreshkitëse djathtas
- Parakolpi i ljer ne ngjyrën e makinës
- Mbrojtje për furnizim me karburantin e gabuar
- Rezervuari i karburantit të jetë jo më i vogël se 70 litra
- Dere e pasme
- Jastëk sedije i rregullueshem për shoferin
- Jastëk sedilje i rregullueshem për pasagjerin
- Sedile komfort shoferi
- Sedile komfort pasagjeri
- Sedile te rrotullueshme përballë
- Mbështetëse krahu për pasagjeret
- Sistemi me shina i sediljes me fiksion të shpejtë
- Rreshti i pare me 3 sedile, sedilja e pare e palosshme
- Rreshti i dyte me 3 sedile
- Sistem me ajër të nxehtë në kompartimentin e pasagjerëve
- Ajër i kondicionuar, semi-automatik, i kontrolluar
- Ngrohje ndihmëse elektrike
- Ajër i kondicionuar, semi-automatik, i kontrolluar ne pjesën e pasme
- Pjesa qendrore e kroskotit me mbajtëse gotash dhe sirtar mesatar
- Kroskot me kyçje
- Dy mbajtëse gotash
- Timon i rregullueshëm lartësi
- Pasqyre e pasme e brendshme
- Instrumente ne ekran me ngjyra
- Paneli i kontrollit te sipërm komfort
- Mbështetëse mesi, pasagjeri
- Mbështetëse mesi, shoferi
- Doreze për hyrje
- Ekzekutimi më i lartë i paneleve të brendshme
- Navigator dhe përditësimin e hartave për një periudhe 3 vjeçare
- Altoparlante me 2 zona
- Frena e dorës elektrike
- Asistenti i frenimit aktiv
- Mbyllje konveniente
- Pasqyra te jashtme me palosje dhe elektrike + ngrohje
- Telekomande
- Alarm për rripin e sigurimit/ pasagjeri
- Alarm për rripin e sigurimit/ shoferi
- Asistenti i këndit te verbër
- Asistenti për erërat e forta
- Asistenti i aktiv i ruajtjes se korsisë
- Asistenti i vëmendjes
- Llamba halogjene

- Rregullator i drejtimit te dritave
- Asistenti i dritave
- Llamba e tretë e ndalimit
- Llambe dalje
- Ndriçim tek doreza
- Ndriçim tek këmbët
- Ndriçimi i ambientit
- Dritat e frenimit adaptive
- Kufizuesi variabël i shpejtësisë
- Airbag, Pasagjeri
- Airbag, Shoferi
- Airbag anësor, shoferi
- Airbag anësor pasagjeri
- Airbag krah xhamave
- Njohësi i fëmijës ne mjet, pasive
- Bllokimet e sigurisë së fëmijëve në dyert e compartmentit të pasagjerëve
- Timon multifunksional
- Asistenti i nisjes ne malore
- Karikues Wireless
- Dalje , 12 V
- Prize 12 V
- Tregues temperature
- Ndricim interiori dhe ambienti
- Sistemi ECO start/stop

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritura nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfituese, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Theksojme se edhe afati i levrimit është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor përfituese, sipas konsultimeve me operatorët ekonomik që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e shitblerjes së automjeteve.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**